

**THIRRJE PUBLIKE PËR PARASHTRIMIN E KËRKESËS NË LIDHJE ME PROGRAMIN PËR REFUNDIMIN E MJETEVE TË PAGUARA SI DETYRIME DOGANORE, TATIMI I VLERËS SË SHTUAR DHE AKCIZAT PËR FURNIZIM ME AUTOMJET PËR UDHËTARË PËR PERSONAT ME TË PAKTËN 80% INVALIDITET NË EKSTREMITETET E POSHTME, PERSONA ME PENGESË MESATARE, TË RËNDË DHE TË THELLË INTELEKTUALE, PERSONAT PLOTËSISHT TË VERBËR ME SHOQËRUES DHE PERSONAT PLOTËSISHT TË SHURDHËR PËR VITIN 2017**

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në kuadër të Programit për ndryshimin e programit për refundimin e mjeteve të paguara si detyrime doganore, tatimi i vlerës së shtuar dhe akcizat për furnizim të automjetit për personat me të paktën 80% invaliditet në ekstremitetet e poshtme, persona me pengesë mesatare, të rëndë dhe të thellë intelektuale, persona plotësisht të verbër me shoqërues dhe persona plotësisht të shurdhër për vitin 2017 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 192/16) shpallë thirrje publike për paraqitjen e kërkesave për refundimin e mjeteve të paguara si detyrime doganore, tatimi i vlerës së shtuar dhe akciza për furnizim të automjetit.

Kërkesën mund ta parashtrojë personi me invaliditet, prindi ose kujdestari i tij më së voni deri më 30 shtator të vitit 2017.

Kërkesa me dokumentacionin e nevojshëm parashtrohet përmes Qendrës kompetente për punë sociale deri te Komisioni për refundimin e mjeteve për blerjen e automjetit për udhëtarë, komision ky i formuar në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale.

Bashkëngjitur me kërkesën parashtrohet edhe dokumentacioni, si vijon:

- Diagnoza, vlerësimi dhe mendimi nga Komisioni kompetent për përcaktimin e dëmtimit trupor së paku 80% të ekstremiteteve të poshtme, për pengesën e përcaktuar mentale mesatare, të rëndë dhe të thellë, për verbërinë e plotë dhe për shurdhëri të plotë (apo kopje nga dokumenti, i vulosur te noteri);
- Një kopje ose kopje e vulosur nga deklaracioni doganor, jo më të vjetër se 12 muaj nga dita e pagesës së detyrimeve doganore dhe akcizave gjatë importit të automjetit për udhëtarë, e lëshuar nga organi doganor;
- Dëshmi për pagesën e tatimit të vlerës së shtuar gjatë furnizimit me automjet për udhëtarë;
- Diagnozë dhe mendim për anëtar tjetër të familjes me invaliditet (ose kopje të dokumentit të vulosur te noteri);
- Vërtetim për të hyrat e realizuara nga Drejtoria e të Ardhurave Publike për vitin paraprak;

- Vërtetim për student i rregullt (nëse personi është student);
- Vërtetim për themelimin e marrëdhënies së punës (nëse personi është në marrëdhënie pune);
- Vërtetim për kërkues i regjistruar aktiv për punë (nëse personi është i papunë).

Për informacioni shtesë mund të drejtoheni çdo ditë pune prej orës 10.00-12.00 në tel. 02 3106 770 ose në Qendrën kompetente të vendit për punë sociale

MINISTRIA E PUNËS DHE POLITIKËS SOCIALE